**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA**

22-08-2024

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA
MARRË NË DORËZIM-PRIMLJENO-RECEIVED

| Njësia org. / Org. Jedinica / Org. Unit | Numri / Broj / Number | Shtojca / Prilog / Appendix | Vlera / Vrednost / Value |
| --- | --- | --- | --- |
| 01 | 016 | 49450 | / |

| | | |
| --- | --- | --- |
| 11 Nr. | Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluejtshme të Komunës | Datë: 16.08.2024 |

| | |
| --- | --- |
| Për: | Kryetarin e Komunës **Z.Bali MUHARREMAJ** |
| Nga: | Komisioni Komunal për zhvillimin e procedurave dhe shqyrtimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale. |
| Lënda: | Vlerësimi dhe Rekomandimi për Konkurimin e Hapur 01/2024,i shpallur me datë 22.07.2024 |

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-24225të datës 29/04/2024 të Asamblesë Komunale dhe në bazë të procesverbalit nr. 01/2024 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 22.07.2024 komisonit përkatës paraqet këtë :

RAPORT:

Me date 19.07.2024 është mbajtur takimi me anëtarët e komisonit për përcaktimin e kushteve për aplikim dhe kritereve për vlerësim, ku është publikuar ftesa për :

- **KONKURIM I HAPUR Nr. 01/2024**, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15 ( pesëmbëdhjetë) vite deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës komunale për:

1. Parcela- **P-72116035-00151-0,**me sipërfaqe të përgjithshme prej: **S=3177m²,**sipas hartës zonale, pasuri shoqërore në emër të " Komuna e Suharekës", nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lartë ndahen për dhënien në shfrytëzim vetëm **S=2349 m².**

Në bazë të afateve ligjore të përcaktuara me Ligjin Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluejtshme të Komunës ( **Ligji Nr. 06/L-092**), komisioni ka caktuar datën **05.08. 2024** për tërheqjen e formularit të ofertave**,** zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Si datë për pranimin dhe hapjen e ofertave ka përcaktuar datën **05.08.2024** në ora **14:00** në zyrën e prokurorimit në Komunën e Suharekës.

Në bazë të listës së prezantuar nga zyra pritëse e administrates te gjendja civile , formularët për aplikim i kanë tërhequr gjithsej 2 (dy ) ofertues, dhe deri në afatin e dhënë në Konkurim të Hapur janë dorzuar gjithësej 2 (dy) oferta me numër protokolli :**oferta e parë** 01/0/6/04130 datë 05.08.2024 , **oferta e dytë** 01/16/43136 datë 05.08.2024.

Për vlersimin e parcelës:-**P-72116035-00151-0,** me sipërfaqe prej : **S=3177m²,** në vendin e quajtur **"GRAB,"zone kadastrale Reshtan,** kanë aplikuar 2 persona.

Në bazë të kontrollimit dhe vlerësimit të dokumentacioneve të aplikantëve që kanë ofertuar në këtë konkurimin e hapur për parcelën kadastrale:

1. Parcela kadastrale e cila gjendet në Reshtan Komuna Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **3177m²,** sipas certifikatës së pronës **P-72116035-00151-0** në zona kadastrale Reshtan, vendi i quajtura **"Grab"** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, për ushtrimin e aktivitetit biznesor.

Nga vlerësimi i tërësishëm i komisionit vlerësues, për konkurimin e hapur Nr.01-2024 i shpallur me datë 22.07.2024 , komisioni me datë 06.08.2024 ka bërë vlerësimin e ofertave për parcelën: **P-72116035-00151-0 dhe rekomandojmë si fitues:**

**<u>Design Lift SH. P.K. me perfaqsues Beqir Krasniqi</u>**

Numri i pikëve 93.4pikë.

Fillimisht komisioni ka caktuar datën 06.08.2024 si datëpër vlerësimin e ofertave . Gjatë vlerësimit të ofertave komisioni erdhi në përfundim ofertuesi për këtë parcelë në dokumentacionin e ofruar plotëson kushtet sipas njoftimit të komisionit të shpallur ne web faqen e Komunes së Suharekë.

**Rekomandim**

Në bazë të vlerësimit të mësipërm për ofertuesin **Beqir Krasniqi** me numër **<u>ID 1002496174</u>**, komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale rekomandon për parcelën:

1. Parcela kadastrale e cila gjendet në Reshtan"Grab" në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **3177m²,** sipas certifikatës së pronës **O-72116035-00151-1-0** me numër zona kadastrale **Reshtan** vendi i quajtura **"Grab"** e evidentuar pasuri shoqërore në emër

të Komunës së Suharekës, për ushtrimin e aktivitetit biznesor, jepen në shfrytëzim vetëm **S=2349 m².**

Nga vlerësimi i tërësishëm i komisionit vlerësues , për parcelën e lartëcekur rekomandojmë si fitues me çmim 0.08 Euro / m² në vit dhe po i njejti ka paraqitur numrin e punetoreve ku do te jetë 27 punëtor, ndersa per nje afat 90 ditor do ta investimin ne vlere prej 321 706.00 euro.

**Konkludim :**

Duke u bazuar që procesi ka rrjedhur ne formë të rregullt dhe te gjitha prodecuar ja zhvilluar në bazë të ligjit ne fuqi:

I nderuar **Kryetar i Komunës z.Bali Muharremaj** dhe **kryesues i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,**

Kërkojmë nga ana juaj që të shqyrtoni punën e komisionit vlerësues dhe të merret vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale në afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet për pronën e paluejtshme komunale të lartëcekuar.

Kryesuesi i Komisionit
**Armend KRASNIQI**